

Lënda: Kallëzim për ndjekje penale ndaj shtetasve Rasim Doda dhe Enkeleda Doda (Kashuri), me funksion Gjyqtarë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Drejtuar : **Z. Adriatik LLALLA,**
PROKUROR I PËRGJITHSHËM,

T I R A N Ë

Baza Ligjore: Neni 257/a/2 dhe 287 i Kodit Penal
Neni 281 i Kodit të Procedurës Penale.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, bazuar në nenin 25/1, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, i ndryshuar, përfundoi kontrollin e plotë të deklaratave të interesave private të subjekteve **Rasim Doda dhe Enkeleda Doda (Kashuri)**, me funksion **Gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë**.

Nga analiza e të gjithë dokumentacionit të administruar në ILDKPKI, lidhur me deklarimin e interesave private të subjekteve Rasim Doda dhe Enkeleda Kashuri (Doda) dhe korrespondencave të institucioneve publike dhe bankare ka rezultuar si më poshtë:

- ✓ **Në deklaratën e interesave private “Para fillimit të detyrës” në vitin 2003, subjekti Rasim Doda ka deklaruar:**
 - Depozitë në shumën 1.900.000 lekë në Bankën Amerikane të Shqipërisë. Burimi i krijimit të ardhura nga vëllai me banim në Itali.
 - Të ardhura nga paga neto si Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë në shumën 651.760 lekë.

- ✓ **Në deklaratën e interesave private “Para fillimit të detyrës” në vitin 2003, subjekti Enkeleda Kashuri ka deklaruar:**
 - Apartament 2+1 ndodhur në Vlorë, Lagjia “Dëshmorët”, rruga “I. Zotaj”, Pall. 1213, përfituar nga privatizimi i banesave, regjistruar në datë 26.4.1994.
 - Depozitë në Bankën Kombëtare, e përbashkët me babain, vëllain Hektor Kashuri dhe Enkeleda Kashuri në shumën 372.523 lekë. Burimi i prindërve dhe ndihma ekonomike nga vëllai Hektor Kashuri me banim në Amerikë.
 - Llogari në bankën Kombëtare Tregtare në shumën 100.000 lekë.

- ✓ **Në deklaratën e interesave private “Periodike/Vjetore 2004”, subjekti Rasim Doda ka deklaruar:**
 - Të ardhura nga paga vjetore si Kryetar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë në shumën 1.067.747 lekë.
 - Të ardhura nga shpërblime vjetore 53.000 lekë.

- ✓ Në deklaratën e interesave private "Periodike/Vjetore 2004", subjekti Enkeleda Kashuri ka deklaruar:
- Depozitë në BKT në shumën 336.000 lekë, krijuar në vitin 2004 (Subjekti zotëron 100%).
 - Të ardhura nga paga neto si Gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 768.425 lekë + 39.000 lekë shpërblim.
 - Të ardhura nga pensioni i babait Laze Kashuri, në shumën 168.000 lekë.
 - Të ardhura nga paga dhe bursa e vëllait, student në Universitetin e Bostonit në Amerikë, në shumën 16.800 USD.
 - Të ardhura nga paga dhe bursa e kumatës, studente në Universitetin e Bostonit në Amerikë, në shumën 14.400 USD.
- ✓ Në deklaratën e interesave private "Periodike/Vjetore 2005", subjekti Rasim Doda ka deklaruar:
- Subjekti nuk ka deklaruar ndryshime në asete dhe as të ardhura.
- ✓ Në deklaratën e interesave private "Periodike/Vjetore 2005", subjekti Enkeleda Doda ka deklaruar:
- Depozitë në BKT në emër të babait, Laze Kashuri në shumën 291.922 lekë.
 - Të ardhura nga paga neto si Gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 538.000 lekë.
- ✓ Në deklaratën e interesave private "Periodike/Vjetore 2006", subjekti Rasim Doda ka deklaruar:
- Kontratë Sipërmarrje për prenotim Apartamenti dhe Garazhdi në Tiranë, me sipërfaqe 126 m², me vlerë 129.499 Euro. Porositur me kontratën nr.151 Rep. nr.44 Kol. në Prill të vitit 2006 (Subjekti zotëron 50 %).
 - Detyrim ndaj firmës "Ferrari" shpk në vlerën 48.000 Euro.
 - Të ardhura nga paga vjetore si Kryetar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 1.134.288 lekë.
 - Të ardhura nga shpërblime vjetore 20.000 lekë.
 - Hua e marrë për blerje apartamenti në shumën 35.000 USD, shtetasit Hektor Kashuri me kontratën nr.1008 Rep., nr.540 Kol, datë 1.7.2006.
 - Hua e marrë për blerje apartament në shumën 45.000 Euro, shtetasit Xhevdet Doda me kontratën nr.4054 Rep, nr.1323/2Kol, datë 12.8.2006.
- ✓ Në deklaratën e interesave private "Periodike/Vjetore 2006", subjekti Enkeleda Doda ka deklaruar:
- Pakësuar në shumën 291.922 lekë, shtuar në shumën 50.000 lekë.
 - Kontratë Sipërmarrje për prenotim apartamenti me sipërfaqe 126.11 m² dhe garazhdi në Tiranë, me vlerë 129.499 Euro. Porositur me kontratën nr.151 Rep. nr.44 Kol. në Prill të vitit 2006 lidhur nga b/shorti Rasim Doda (Subjekti zotëron 50 %).
 - Të ardhura nga paga neto si Gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 905.879 lekë.
 - Depozitë në Bankën Kombëtare Tregtare në shumën 50.000 lekë, në emër të subjektit.

- ✓ Në deklaratën e interesave private “Periodike/Vjetore 2007”, subjekti Rasim Doda ka deklaruar:
- Të ardhura nga paga vjetore si Kryetar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 866.202 lekë.
 - Kredi e marrë në Tirana Bank në shumën 42.000 Euro, sipas kontratës nr.54/35 Rep, nr.2438/3 Kol, datë 15.11.2007. Shlyer këste kredie në shumën 228 Euro.
 - Shlyer me këste Hua në shumën 10.000 USD shtetasit Hektor Kashuri.
- ✓ Në deklaratën e interesave private “Periodike/Vjetore 2007”, subjekti Enkeleda Doda ka deklaruar:
- Pakësuar depozita në Bankën Kombëtare Tregtare në shumën 50.000 lekë, në emër të subjektit.
 - Të ardhura nga paga neto si Gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 723.462 lekë.
 - Kredi e marrë në Tirana Bank në shumën 42.000 Euro, sipas kontratës nr.5435 Rep, nr.2438/3 Kol, datë 15.11.2007, me afat 10 vjet, me interes 6 %. Shlyer këste kredie në shumën 228 Euro.
 - Shlyer me këste Hua në shumën 10.000 USD shtetasit Hektor Kashuri.
- ✓ Në deklaratën e interesave private “Periodike/Vjetore 2008”, subjekti Rasim Doda ka deklaruar:
- Të ardhura nga paga vjetore si Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 752.633 lekë.
 - Shlyer nga kredia e marrë në Tirana Bank shuma 5.336 Euro, me burim shuma 2.000 Euro në llogari. Mbetur gjendje detyrimi në shumën 38.949 Euro (principal).
 - Shlyer Hua në shumën 5.000 USD shtetasit Hektor Kashuri.
- ✓ Në deklaratën e interesave private “Periodike/Vjetore 2008”, subjekti Enkeleda Doda ka deklaruar:
- Të ardhura nga paga vjetore si Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 812.588 lekë.
 - Shlyer nga kredia e marrë në Tirana Bank shuma 5.336 Euro, nga të cilat 1.422 Euro me burim nga shuma 2.000 Euro në llogari. Mbetur gjendje detyrimi në shumën 38.949 Euro (principal).
 - Shlyer Hua në shumën 5.000 USD shtetasit Hektor Kashuri.
 - Subjekti Enkeleda ka deklaruar edhe asetete te prindërve.
- ✓ Në deklaratën e interesave private “Periodike/Vjetore 2009”, subjekti Rasim Doda ka deklaruar:
- Të ardhura nga paga vjetore si Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 778.665 lekë.
 - Shlyer nga kredia e marrë në Tirana Bank shuma 5.631 Euro, mbetur gjendje detyrimi në shumën 36.101 Euro.
 - Shlyer Hua në shumën 5.000 USD shtetasit Hektor Kashuri, shlyer totalisht detyrimi.
 - Huaja e marrë shtetasit Xhevdet Doda është falur në datë 10.03.2010, me deklaratë noteriale.

- ✓ Në deklaratën e interesave private “Periodike/Vjetore 2009”, subjekti Enkeleda Doda ka deklaruar:
 - Të ardhura nga paga vjetore si Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 893.585 lekë.
 - Shlyer nga kredia e marrë në Tirana Bank shuma 5.631 Euro, mbetur gjendje detyrimi në shumën 36.101 Euro.
 - Shlyer Hua në shumën 5.000 USD shtetasit Hektor Kashuri, shlyer totalisht detyrimi.
 - Huaja e marrë shtetasit Xhevdet Doda është falur në datë 10.3.2010, me deklaratë noteriale (lidhur).

- ✓ Në deklaratën e interesave private “Periodike/Vjetore 2010”, subjekti Rasim Doda ka deklaruar:
 - Blerë autoveturë me kontratë shitblerje nr.5565 Rep, nr.1984 Kol, datë 2.8.2010, në shumën 600.000 lekë. Paguar shitësit shuma 300.000 lekë, mbetur gjendje detyrimi 300.000 lekë (Subjekti zotëron 50%). B/lidhur kontrata.
 - Të ardhura nga paga vjetore si Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 760.788 lekë.
 - Shlyer nga kredia e marrë në Tirana Bank shuma 5.473 Euro, mbetur gjendje detyrimi në shumën 32.153 Euro.
 - Detyrim ndaj shitësit të automjetit në shumën 300.000 lekë.

- ✓ Në deklaratën e interesave private “Periodike/Vjetore 2010”, subjekti Enkeleda Doda ka deklaruar:
 - Bashkëshorti ka blerë autoveturë me kontratë shitblerje nr.5565 Rep, nr.1984 Kol, datë 2.8.2010, në shumën 600.000 lekë. Paguar shitësit shuma 300.000 lekë, mbetur gjendje detyrimi 300.000 lekë (Subjekti zotëron 50%).
 - Të ardhura nga paga 9-muaj si Gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 644.379 lekë.
 - Shlyer nga kredia e marrë në Tirana Bank shuma 5.473 Euro, mbetur gjendje detyrimi në shumën 32.153 Euro.
 - Detyrim ndaj shitësit të automjetit në shumën 300.000 lekë.

- ✓ Në deklaratën e interesave private “Periodike/Vjetore 2011”, subjekti Rasim Doda ka deklaruar:
 - Të ardhura nga paga vjetore si Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 805.823 lekë.
 - Shlyer nga kredia e marrë në Tirana Bank shuma 5.975 Euro, mbetur gjendje detyrimi në shumën 28.238 Euro.
 - Paguar detyrimi ndaj shitësit të automjetit në shumën 300.000 lekë, i deklaruar në vitin 2010.

- ✓ Në deklaratën e interesave private “Periodike/Vjetore 2011”, subjekti Enkeleda Doda ka deklaruar:

- Të ardhura nga paga vjetore si Gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 897.998 lekë.
 - Të ardhura nga Raporti leje lindje në shumën 241.536 lekë.
 - Shlyer nga kredia e marrë në Tirana Bank shuma 5.975 Euro, mbetur gjendje detyrimi në shumën 28.238 Euro.
 - Paguar detyrimi ndaj shitësit të automjetit në shumën 300.000 lekë, i deklaruar në vitin 2010.
- ✓ Në deklaratën e interesave private “Periodike/Vjetore 2012”, subjekti Rasim Doda ka deklaruar:
- Të ardhura nga paga vjetore si Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 864.836 lekë.
 - Të ardhura nga paga vjetore e bashkëshortes si Gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 942.969 lekë.
 - Shlyer nga kredia e marrë në Tirana Bank shuma 5.760 Euro, mbetur gjendje detyrimi në shumën 23.664 Euro.
 - Shlyer detyrim ndaj shoqërisë “Ferrari Konstruksion” shpk, për blerje apartamenti në vitin 2006, në shumën 2.000 Euro. Mbetur gjendje detyrimi në shumën 3.700 Euro.
- ✓ Në deklaratën e interesave private “Periodike/Vjetore 2012”, subjekti Enkeleda Doda ka deklaruar:
- Të ardhura nga paga vjetore si Gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 942.969 lekë.
 - Të ardhura nga paga vjetore e bashkëshortit si Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 864.836 lekë.
 - Shlyer nga kredia e marrë në Tirana Bank shuma 5.760 Euro, mbetur gjendje detyrimi në shumën 23.664 Euro.
 - Shlyer detyrim ndaj shoqërisë “Ferrari Konstruksion” shpk, për blerje apartamenti në vitin 2006, në shumën 2.000 Euro. Mbetur gjendje detyrimi në shumën 3.700 Euro.
- ✓ Në deklaratën e interesave private “Periodike/Vjetore 2013”, subjekti Rasim Doda ka deklaruar:
- Të ardhura nga paga vjetore si Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 910.217 lekë.
 - Të ardhura nga paga vjetore e bashkëshortes si Gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 1.027.433 lekë.
 - Shlyer nga kredia e marrë në Tirana Bank shuma 5.550 Euro, mbetur gjendje detyrimi në shumën 19.532 Euro.
 - Shlyer detyrim ndaj shoqërisë “Ferrari Konstruksion” shpk, për blerje apartamenti në vitin 2006, në shumën 3.000 Euro. Mbetur gjendje detyrimi në shumën 700 Euro.
- ✓ Në deklaratën e interesave private “Periodike/Vjetore 2013”, subjekti Enkeleda Doda ka deklaruar:
- Të ardhura nga paga vjetore si Gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 1.027.433 lekë.

- Të ardhura nga paga vjetore e bashkëshortit si Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 910.217 lekë.
- Shlyer nga kredia e marrë në Tirana Bank shuma 5.550 Euro, mbetur gjendje detyrimi në shumën 19.532 Euro.
- Shlyer detyrim ndaj shoqërisë "Ferrari Konstruksion" shpk, për blerje apartamenti në vitin 2006, në shumën 3.000 Euro. Mbetur gjendje detyrimi në shumën 700 Euro.

Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit janë kryer veprime verifikuese duke kërkuar informacion pranë institucioneve të specializuara, konkretisht institucioneve bankare dhe institucioneve financiare jo bankare, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, ZQRPP, ZVRPP Tiranë, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, ALUIZNI-t, Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, etj.

Nga të dhënat e mbledhura gjatë procesit të verifikimit të deklaratave të interesave private të këtyre subjekteve, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

- ⊕ Në vitin 2006, subjektet Rasim Doda dhe Enkeleda Doda kanë deklaruar blerjen me kontratë sipërmarrje të një apartamenti dhe garazhdi me vlerë totale 129.499 Euro në Rr. "M.Gjollës" në Tiranë. Për këtë, janë marrë dy hua, njëra në shumën 35.000 USD nga vëllai i Enkeledës, Hektor Kashuri dhe tjetra në shumën 45.000 Euro nga vëllai i Rasimit, Xhevdet Doda. Kontratat e huave janë lidhur me subjektin Rasim Doda. Nga diferenca prej 48.000 Euro, shuma 40.000 Euro i kalon nëpërmjet Tirana Bank shtetasit Arjan Çukaj në datë 27.11.2007, me burim kredinë e marrë po në këtë datë në shumën 42.000 Euro. Referuar kontaktës së paraqitur nr.151/44, pa datë, rezulton se shtetasi Arjan Çukaj është ortak në shoqërinë "Ç & S Konstruksion" shpk dhe jo në shoqërinë "Ferrari Konstruksion" shpk, sikurse deklarohet nga subjektet.

Pra, në vitin 2006, subjektet kanë investuar në asete të paluajtshme, vetëm me likuiditete të personave të tretë, pasi deri në këtë vit ata nuk kanë deklaruar, likuiditete në emër të tyre, në cash apo në sistemin bankar.

- ⊕ Përsa i përket shlyerjes së huave, analizojmë se:

1. Në favor të shtetasit Hektor Kashuri, subjektet Rasim dhe Enkeleda Doda kanë deklaruar shlyerje pjesore në shumën 10.000 USD në vitin 2007; shumën 5.000 USD në vitin 2008 dhe 5.000 USD në vitin 2009, vit në të cilin deklarojnë edhe shlyerje totale të huasë. Huaja e marrë me kontratën nr. 1008/540, dt. 1.7.2006 është në shumën 35.000 USD, ndërsa shuma e shlyerjeve, sipas deklaramit, është në 20.000 USD. Pra, diferenca prej 15.000 USD ose është shlyer dhe nuk është deklaruar, ose nuk është shlyer dhe është deklaruar si e tillë, **që do të thotë se në të dyja rastet ka deklarim të rremë nga ana e subjekteve Doda.**

- Të ardhura nga paga vjetore si Gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 897.998 lekë.
 - Të ardhura nga Raporti leje lindje në shumën 241.536 lekë.
 - Shlyer nga kredia e marrë në Tirana Bank shuma 5.975 Euro, mbetur gjendje detyrimi në shumën 28.238 Euro.
 - Paguar detyrimi ndaj shitësit të automjetit në shumën 300.000 lekë, i deklaruar në vitin 2010.
- ✓ Në deklaratën e interesave private “Periodike/Vjetore 2012”, subjekti Rasim Doda ka deklaruar:
- Të ardhura nga paga vjetore si Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 864.836 lekë.
 - Të ardhura nga paga vjetore e bashkëshortes si Gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 942.969 lekë.
 - Shlyer nga kredia e marrë në Tirana Bank shuma 5.760 Euro, mbetur gjendje detyrimi në shumën 23.664 Euro.
 - Shlyer detyrim ndaj shoqërisë “Ferrari Konstruksion” shpk, për blerje apartamenti në vitin 2006, në shumën 2.000 Euro. Mbetur gjendje detyrimi në shumën 3.700 Euro.
- ✓ Në deklaratën e interesave private “Periodike/Vjetore 2012”, subjekti Enkeleda Doda ka deklaruar:
- Të ardhura nga paga vjetore si Gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 942.969 lekë.
 - Të ardhura nga paga vjetore e bashkëshortit si Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 864.836 lekë.
 - Shlyer nga kredia e marrë në Tirana Bank shuma 5.760 Euro, mbetur gjendje detyrimi në shumën 23.664 Euro.
 - Shlyer detyrim ndaj shoqërisë “Ferrari Konstruksion” shpk, për blerje apartamenti në vitin 2006, në shumën 2.000 Euro. Mbetur gjendje detyrimi në shumën 3.700 Euro.
- ✓ Në deklaratën e interesave private “Periodike/Vjetore 2013”, subjekti Rasim Doda ka deklaruar:
- Të ardhura nga paga vjetore si Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 910.217 lekë.
 - Të ardhura nga paga vjetore e bashkëshortes si Gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 1.027.433 lekë.
 - Shlyer nga kredia e marrë në Tirana Bank shuma 5.550 Euro, mbetur gjendje detyrimi në shumën 19.532 Euro.
 - Shlyer detyrim ndaj shoqërisë “Ferrari Konstruksion” shpk, për blerje apartamenti në vitin 2006, në shumën 3.000 Euro. Mbetur gjendje detyrimi në shumën 700 Euro.
- ✓ Në deklaratën e interesave private “Periodike/Vjetore 2013”, subjekti Enkeleda Doda ka deklaruar:
- Të ardhura nga paga vjetore si Gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë në shumën 1.027.433 lekë.

2. Në lidhje me shtetasin Xhevdet Doda, subjektet Rasim dhe Enkeleda Doda kanë paraqitur kontratën e huasë nr.4054/1323/2, dt.12.8.2006 në shumën 45.000 Euro, sipas së cilës, shlyerja do të bëhet me këste pjesore dhe brenda datës 30.9.2009 do likuidohej totalisht. Në deklaratën e interesave private “Periodike/Vjetore 2009”, të dy subjektet kanë deklaruar se huaja e marrë është falur me deklaratën noteriale të datës 10.3.2010. Në fakt, deklarata e paraqitur në ILDKPKI është deklaratë e thjeshtë dore, pa datë dhe e njësuar me origjinalin nga noter Thoma Kaci, pranë Dhomës së Noterisë Gjirokastër. Në një hark kohor prej 3 vitesh, huaja e marrë në shumën 45.000 euro iu është dhuruar subjekteve deklarues.

Shtetasit, Hektor Kashuri dhe Xhevdet Doda, nuk rezultojnë të jenë marrë me aktivitet biznesi në Shqipëri ose nqs kanë punuar jashtë shtetit, nuk kanë dokumentuar të ardhura që të justifikojnë shumat e dhëna hua, si dhe mënyrën e dërgimit të parave.

Sa më sipër, lindin dyshime të arsyeshme për lidhjen e kontratave fiktive të huasë, me qëllim përdorjen e tyre si burim financiar për pasuritë e deklaruara nga subjektet.

- ± Sipas përgjigjes së Intesa SanPaolo Bank, rezulton se subjekti Rasim Doda ka patur depozitë me gjendje 5.390 Euro dhe 8.796 Euro në dt. 31.12.2003. Referuar deklaramit, subjekti në vitin 2003 ka patur në ISP Bank 1.900.000 lekë, me burim nga të ardhurat e vëllait me banim në Itali. Nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues për sigurimin e këtyre të ardhurave, si dhe nuk ka deklaruar mbylljen e dy depozitave në vitin 2004 dhe as destinacionin e përdorimit të tyre.
- ± Në vitin 2013, meqenëse të ardhurat e deklaruara janë 1.937.650 lekë dhe subjektet kanë deklaruar shlyerje kredie 5.550 Euro + shlyerje detyrimi 3.000 Euro ndaj shoqërisë “Ferrari Konstruksion” shpk, duke llogaritur edhe shpenzimet e konsumit familjar minimal sipas INSTAT (të cilat për 5 persona janë 1.101.900 lekë), rezulton me mosmbulim me burime financiare në shumën rreth 360.000 lekë.
- ± Nga shqyrtimi i deklarameve të dy subjekteve vërehet se nga viti 2003 e deri aktual, punojnë gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë. Nuk kanë deklaruar në asnjë nga deklaratat e interesave private shtëpi në pronësi apo të marrë me qera në Sarandë. Përveç kësaj, subjektet kanë deklaruar adresë banimi në Rr. “3 Vëllezërit Kondi” Tiranë. Nuk dihet lidhja e subjekteve me këtë adresë dhe nëse ka patur investim nga ana e tyre në këtë pasuri. Adresa e mësipërme nuk korrespondon me shtëpinë e blerë dhe të deklaruar prej tyre në vitin 2006.
- ± Nga shkresa nr. 63/4 prot, dt. 2.4.2015 e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë , si dhe nga deklaratat e subjekteve deklarues, evidentohet se;
- Nga viti 2005 deri në vitin 2008, subjekti Rasim Doda ka qenë në funksionin e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ndërsa b/shortja e tij Enkeleda Doda ka qenë gjyqtare pranë kësaj gjykate.
 - Nga viti 2008 e në vazhdim, dy subjektet Doda janë gjyqtarë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Ushtrimi i funksionit i të dy bashkëshorteve si gjyqtarë në të njëjtën gjykatë, lë vend për dyshime për konflikt në dukje të interesit, në lidhje me njëanshmërinë dhe dhënien e drejtësisë në gjykim.

- ✚ Sipas shkresës së ZVRPP Sarandë nr. 2093 prot, dt. 10.9.2013, rezulton se shtetasi Rasim Doda ka okupuar truall me sip. 654 m², me nr.pasurie 7/169, volumi 5, fq.240 Ksamil, Sarandë.
Së pasi, referuar deklaramit të pasurisë, subjekti Doda nuk e ka deklaruar këtë aset pavarësisht mënyrës së përfutimit dhe së dyti, është pikërisht kjo mënyrë përfutimi (nëpërmjet okupimit të pronës së një pronari të ligjshëm) që nuk është e denjë për një zyrtar që pretendohet se jep drejtësinë.

Në përfundim të verifikimeve të kryera mbi deklaratat e interesave private të subjekteve Rasim Doda dhe Enkeleda Doda dhe të dhënave të siguruara gjatë procesit të kontrollit, u konstatuan problemet si më poshtë vijon:

- ✚ **Deklarim i rremë lidhur me shlyerjet e huasë ndaj shtetasit Hektor Kashuri, (deklarohet e shlyer totalisht ndërkohë që diferenca e mbetur pa shlyer është 15.000 USD).**
- ✚ **Deklarim i rremë dhe mosjustifikim me dokumentacion justifikues ligjor për mundësinë financiare të shtetasve, Hektor Kashuri dhe Xhevdet Doda, për shumat e dhëna hua 35.000 USD dhe 45.000 Euro.**
- ✚ **Dyshime të arsyeshme për lidhjen e kontratave fiktive të huasë, me qëllim përdorjen e tyre si burim financiar për pasuritë e deklaruar nga subjektet Rasim dhe Enkeleda Doda.**
- ✚ **Pasaktësi në deklaramin e vitit 2003 për depozitë në shumën 1.900.000 lekë, e cila sipas Bankës Amerikane të Shqipërisë është 5.390 Euro dhe 8.796 Euro.**
Mosdeklarimin e mbylljes së dy depozitave në vitin 2004 dhe as destinacionin e përdorimit të tyre.
Mosparaqitje e dokumentacionit për justifikimin e burimit të dy depozitave, i cili është deklaruar nga të ardhurat e vëllait të subjektit Rasim Doda me banim në Itali.
- ✚ **Mosmbulim me burime financiare në vitin 2013 në shumën rreth 360.000 lekë.**
- ✚ **Fshehje e pasurisë truall me sip. 654 m², me nr. pasurie 7/169, volumi, 5, fq.240 Ksamil, Sarandë, përfutuar nëpërmjet okupimit nga subjekti Rasim Doda.**
- ✚ **Konflikt në dukje të interesit për ushtrimin e funksionit të dy bashkëshorteve si gjyqtarë në të njëjtën gjykatë.**

Në përfundim të kontrollit të plotë dhe rikontrollit të deklaratave të interesave private të subjekteve Rasim Doda dhe Enkeleda Doda, në deklaratat “Para fillimit të detyrës 2003” deri në vitin 2013, bazuar në rezultatet e veprimeve verifikuese të kryera, administrimit të provave dhe deklarimeve të bëra është arritur në përfundimin **se subjektet kanë deklarim të rremë, kontrata**

fiktive, kanë mungesë burimesh financiare, nuk kanë deklaruar pasuri të paluajtshme, likuiditete, interesat e tyre private dhe burimet e krijimit të tyre.

Për arsytet e sipërpërmendura, bazuar në nenin 281 të K.Pr.Penale, paraqesim para Jush këtë kallëzim penal duke kërkuar fillimin e procedimit penal për veprën penale, të parashikuar nga neni 257/a/2 dhe 287 i K.Penal, ndaj subjekteve Rasim Doda dhe Enkeleda Doda.

Në përfundim, i kërkojmë organit të akuzës që gjatë shqyrtimit të materialeve kallëzuese të marrë në konsideratë dhe mundësinë e ekzistencës së figurave të veprave të tjera penale, të cilat konkurrojnë me figurën e veprës penale për të cilën është depozituar kallëzimi.

Bashkëlidhur, dërgojmë kopje të njehsuara me origjinalin të deklaratave të interesave private të subjekteve Rasim Doda dhe Enkeleda Doda, si edhe të akteve të mbledhura gjatë procesit të verifikimit të deklaratave të tyre..

Faleminderit për bashkëpunimin!